

SHTOJCA 2

**BASHKIA KAMEZ
KESHILLI BASHKIAK**

**Struktura e Dokumentit së Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor FAZA E DYTE,
2026-2028**

Dhe Buxheti Vjetor 2026



BASHKIA KAMEZ

DOKUMENTI

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM 2026 - 2028

FAZA E DYTE

Dhe Buxheti Vjetor 2026

Shtator 2025

PËRMBAJTJA

LOGO	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
1. HYRJE	5
1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM, SI NJË INSTRUMENT EFEKTIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR.....	5
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË	7
2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË (1-2 FAQE).....	9
2.1 SITUATA E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE	9
2.2 ÇËSHTJE KRYESORE PËR PROJEKTET DHE POLITIKAT E BASHKISË / KËSHILLIT TË QARKUT	10
3. ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË / KAMËZ (1-2 FAQE).....	12
3.1 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT AFATGJATË.....	12
3.2 SËDAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT / PARAQITJA E PROJEKTEVE KRYESORE – ARSYET DHE PËRFITUESIT	12
4. BUXHETI AFATMESEM I BASHKISË/KAMËZ 2025-2027	14
4.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË/KAMËZ NË VITET 2025-2027	15
4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë/ Kamëz për vitet 2025-2027	15
2.1.2 Plan i Shpenzimeve të Bashkisë/ Kamëz për periudhën 2025-2027	29
4.2 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR	54
5. BUXHETI AFATMESEM PËR PROGRAMET BUXHETORE	56
5.1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	56
5.1.2 Plan i Shpenzimeve të Produkteve të Programit	57
5.1.3 Projektet e Investimeve të Programit	61
5.1.4 Informacione Bazë mbi Programin	61
6. BUXHETI VIETOR	62
6.1. DOKUMENTACIONI BAZË	62
6.2. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES	62

Lista e Tabelave

Tabela 1. Informacion Bazë mbi Bashkinë/Kamëz.....	14
Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit.....	15
Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.....	29
Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike.....	52
Tabela 5. Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funkcional (Niveli I, II, III i COFOG)	53
Tabela 5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike.....	56
Tabela 6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit.....	56
Tabela 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	57
Tabela 8. Projektet e Investimeve të Programit.....	61
Tabela 9. Informacione bazë mbi Programit	61

Lista e Shkurtimeve

PBA	– Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVV	– Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP	– Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS	– Grupi për Menaxhimin Strategjik
MF	– Ministria e Financave
FPT	– Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT	– Instituti i Statistikave
PBB	– Produkti i Brendshëm Bruto
SMBV	– Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor

1. HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjeçare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohej një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve.

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxheti vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësitë vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësitë vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxheti që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e performancës të lidhura me ato në terma SMART¹. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë² (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjeçare³, sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

¹ Specifike, Matshme, Arritshme, Rëndësishme, Terma Kohore.

² 'Afatgjatë' i referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

³ Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së. Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësi vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart⁴ i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MF-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave

⁴ Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për "Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar.

buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor).

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2026-2028 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavanëve të përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV) dhe Manualin e Përdorimit të tij.

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MF, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do të paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Faza 3 e procesit të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor përshkon periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor kur NJVQV-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmësëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin e MF). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së

2. Vështrim i Përgjithshëm i Bashkisë (1-2 faqe)


2.1 Situata e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore

Bashkia Kamëz është një bashki e re e ndërtuar gjatë 30 viteve të fundit ku rritja e popullsisë ka qenë me përmasa të jashtëzakonshme, rrjedhimisht edhe nevojat për përmirësimin e infrastrukturës kanë qenë gjithnjë e në rritje.

Kamza shtrihet në zonën qendrore të Republikës së Shqipërisë, ajo kufizohet nga tre bashki si ajo e Tiranës, Vorës dhe Krujës.

Bashkia KAMËZ në kuadër të reformës territoriale, kjo njësi ka pësuar ndryshime të konsiderueshme në sipërfaqe, në territor dhe në popullsinë e saj, ku veçori kryesore është dhe bashkimi i territorit të njesisë administrative Paskuqan me të.

Bashkia KAMËZ përbëhet nga qyteti i KAMZËS, dhe 14 (katërmëdhjetë) fshatra duke përfshirë dhe fshatrat e Njesisë Administrative Paskuqan. Ndër të përmendim: 'Fshatrat: Bathore, Laknas, Valias, Frutikulturë, Bulqesh, Zall-Mner, Paskuqan, Babrru-Qendër, Kodër e Kuqe, Shpat, Fushë e Kërçikëve, Kodër Babrru, Paskuqan Fushë, Paskuqan Kodër. Sipërfaqja administrative e saj arrin në rreth **39,27 Km²**, me një popullsi civile të regjistruar e cila arrin në rreth **160,000 banorë**.



Kamza tashmë është një qytet me zhvillime intensive dhe me tendencë mjaft pozitive në të gjitha fushat social ekonomike, e dëshmuar kjo në 20 vitet e fundit.

Sa e re dhe bashkëkohore aq dhe e rëndësishme për vetë pozicionin strategjik pranë Kryeqytetit Tiranë, Aeroportit të Rinasit, dhe Portit të Durrësit.

Një ndër qytetet me të reja në Shqipëri, Bashkia Kamëz e dyta më e madhe në Qarkun e Tiranës dhe gjashta në Shqipëri.

Projekt buxheti është një proces listimi dhe analizimi të problemeve dhe sfidave emergjente, programeve dhe projekteve afatshkurtra dhe afatmesme. Gjatë gjithë periudhës komunikimi me komunitetin, takimet dhe diskutimet publike kanë ndihmuar për të përcaktuar shqetësimet dhe nevojat aq të shumta dhe me mundësi të kufizuara për tu realizuar.

Buxheti vjetor 2026 dhe PBA 2026-2028, synon përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit.

Dokumenti i plan buxhetit të PBA 2026-2028, ka marrë gjithë përgjegjshmërinë e domosdoshme në të gjithë hapat e hartimit të tij dhe tanimë është një dokument i plotë në formë e përmbajtje, në përmbushje të vizionit të Strategjisë së Zhvillimit të Ekonomisë Lokale të Bashkisë Kamëz.

Me moton mbi të cilën orientojmë zhvillimin ekonomik, ambicies sonë për të përmirësuar jetën e komunitetit dhe në përgjigje të përmbushjes të kërkesave në rritje të tij, ky dokument materializon objektiva të qarta, të matshme dhe të

implementueshme, si në planin afat shkurtër dhe në atë afatgjatë për një periudhë tre vjeçare.

Ne nuk po përmbushim thjesht një detyrim ligjor për informim, por po bëjmë transparencën publike dhe mediatike të të gjithë angazhimit tonë profesional dhe moral, në hartimin e këtij dokumenti, nga me të rëndësishmit vendime që merr Këshilli Bashkiak.

Me motivin **“Buxheti nuk është liste dëshirash”** por një plan financiar që balancon burimet financiare të mundshme me nevojat më të domosdoshme e prioritare, gjatë ushtrimit të funksioneve të njësisë së qeverisjes vendore të përcaktuara me ligj, **Bashkia Kamez ftoi gjithë grupet e interesit të bëhen pjesë e përgatitjes së këtij dokumenti.**

Objekti prioritar i këtij projektbuxheti është Përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe arsimore në të gjithë teritorin e Bashkisë Kamëz, rritja e numërit të të punësuarve, zhvillimi ekonomik si dhe rritja e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve.

E ardhmja e çdo shoqërie varet nga fëmijët. Ata janë punëtorët e ardhshëm, prindërit, mësime dhënësit, mjekët dhe politikanët. Nëse ne nuk u sigurojmë atyre bazë për jetë të shëndetshme dhe produktive sot, atëherë ne vëmë në rrezik të ardhmen, prosperitetin dhe sigurinë tonë. Kjo është arsyeja pse vëmendja jonë është e përqendruar në ndërtimin e një infrastrukture moderne arsimor dhe rrugore, sistem që do të krijojë gjenerata progresive në të ardhmen me qëllim për ta çuar vendin përpara.

2.2 Çështje Kryesore për Projektet dhe Politikat e Bashkisë / Këshillit të Qarkut

(Burimi i Informationit: PPV / PZHS)

Në bazë të një plan-veprimi u realizuan dëgjuesat publike në të gjithë bashkinë. Dëgjesa u organizuan edhe me grupet e interesit, e shoqërinë civile.

Problematikat e dala nga keto dëgjesa që kishin të bënin kryesisht me infrastrukturën rrugore, rrjetin e kanalizimeve të ujerave të zeza, përmirësimin e ndiçimit, shtimin e sipërfaqeve të gjelberta, përmirësimin e furnizimit me ujë të pishëm,... etj. U adresuan në Ndërmarrjet, institucionet dhe Drejtoritë përkatëse që të jenë pjesë integrale e Plan Buxhetit (PBA) 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026.

Në lidhje me hapat e mëtejshme të Buxhetit vjetor 2026 dhe përgatitjes së plan buxhetit afat mesem 2026-2028, gjatë muajve janar-prill u punua nga specialistët përkatës të Drejtorive të Bashkisë në planifikimin për çdo zë të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke arritur të sjellim një buxhet ambicioz në planifikimin e të ardhurave dhe sa më real dhe më afër qytetarëve në drejtim të shpenzimeve.

Është punuar dhe do të punojmë mirë, me përgjegjësi, duke zbatuar me rigorozitet ligjin, me transparencë, duke përdorur burimet e financimit në mënyrë eficiente për gjërat e duhura, me besimin se vetëm kështu mund të ndryshojmë dhe të zhvillohemi.

Rekrutimin i burimeve njerëzore cilësore dhe trajnimi i vazhdueshëm për permiresimin e punës në administrim. Modernizimi i punës në administratën publike përmes zhvillimit dhe përdorimit të inovacionit, elektronikës dhe teknologjisë së komunikimit janë një alternativë që e mbështesim fort.

Si një zonë e re urbane dhe me densitet të lartë të popullsisë, zhvillimi i infrastrukturës së duhur për ujesjellës, kanalizime, rrugë, sheshe publike apo parqe si dhe ndërtimi i shkollave, kopshteve, çerdheve e qendrave shëndetësore, përmirësimi në vijimesi sidomos i shërbimeve publike, kujdesi, pastrimi e mbrojtja e mjedisit, mirëmbajtja e infrastrukturës ekzistuese, ndricimi i ambjenteve publike, **janë sfidat kryesore të bashkisë sone.**

Në Kamëz mësojnë dhe edukohen mbi 21 mijë, nxënës në nivele të ndryshme të arsimit. Përmirësimi i kushteve dhe përafrimi i standarteve do të jetë perpjekja dhe sfida e punës sonë. Kujdesi dhe shërbimet për fëmijët, për të rinjtë, për personat me aftësi ndryshe do të jetë një risi duke besuar se kështu mund të ndihmojmë për një shoqëri të shëndetshme.

Femije qe frekuentojne kopshtet dhe çerdhet jane rreth 6,000 femije nga keto rreth 5,100 frekuentojne kopshtet dhe rreth 900 femije frekuentojne çerdhet.

Ne kopshte dhe çerdhe shumica e femijeve jane me ushqim dhe me kushte shume te mira.

3. Orientimi Afatgjatë i Bashkisë Kamëz

3.1 Strategjia e Zhvillimit Afatgjatë

(Burimi i Informacionit: PPV / PZHS)

3.2 Sfidat Kryesore të Zhvillimit / Paraqitja e Projekteve Kryesore – Arsyet dhe Përfituesit

(Burimi i Informacionit: PPV / PZHS; Fishat e Projekteve, të tjera)

Në hartimin e këtij projektbuxheti është pasur parasysh,

1. Plani rregullues urban i qytetit të Kamzës si dhe Plani i Paskuqanit i cili është miratuar i bashkuar me Njësinë Paskuqan.
2. Misioni i Bashkisë Kamëz si njësi e vetëqeverisjes vendore është,

“Vënia në dispozicion në mënyrë inteligjente e të gjitha burimeve financiare e njerëzore për harmonizimin e interesave publike dhe private, për zhvillim ekonomik e social në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz”.

3. Strategjia e Bashkisë Kamëz për mjedisin.
4. Ngritjen e kapaciteteve për zhvillimin e biznesit dhe të qendrave industriale.
5. Standardet e Politikave që duhet të arrijë Bashkia për çdo program (aktivitete).
6. Treguesit faktikë për disa vite buxhetore paraardhëse, fondet buxhetore të planifikuara për vitin në vazhdim si dhe shpërndarjen e vlerës totale të tavaneve të programit buxhetor afatmesëm sipas programeve për tri vitet e ardhshme buxhetore.
7. Shpenzimet kapitale në formën e listës së projekteve të investimeve për çdo program, ku përcaktohet kostoja e plotë e projektit, si dhe vlera e parashikuar për t'u financuar në vitin buxhetor koherent. Në këto janë paraqitur:
 - vlera e financuar e investimeve në nivel objekti deri në fund të vitit buxhetor paraardhës,
 - vlera e mbetur për t'u financuar në vitet pasardhëse buxhetore për çdo nivel investimi.
8. Janë përcaktuar treguesit financiarë dhe elementet e vlerësimit të buxhetit për secilin program, bazë mbi të cilën janë bërë përlllogaritjet për përcaktimin e fondeve të shpenzimeve për këto programe.
9. Planifikimi i të ardhurave është bërë në bazë të një kalkulimi të detajuar për çdo lloj të tyre mbi bazën e të dhënave dhe treguesve financiarë realë, si dhe elementit të vlerësimit të buxhetit për secilën të ardhur.
10. Është bërë përcaktimi në vlerë dhe detajimi i hollësishëm i detyrimeve të papaguara nga viti i mëparshëm sipas programeve.

11. Në hartimin e projektbuxhetit është pasur parasysh ligjshmëria, rregullshmëria dhe respektimi i parimeve të ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit.

12. Është bërë bashkërendimi i punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të bashkisë me pjesëmarrjen e komunitetit dhe bashkërendimi i punës me të gjitha drejtoritë dhe ndërmarrjet e bashkisë.

VIZIONI DHE MISIONI I BASHKISË KAMËZ, OBJEKTIVAT E BUXHETIT TË PROJEKT BUXHETIT AFATMESEM 2026-2028.

Objektivi 1: Zhvillimi i harmonizuar i një ekonomie konkurruese në tregun rajonal, me biznese kryesisht të tregetise, që zgjerohen e inkurajohen për të pasur diversitet e cilësi.

Objektivi 2: Zhvillimi i ekuilibruar i territorit në përputhje me parametrat bashkëkohore mjedisore dhe urbane.

Objektivi 3: Një jetë sociale cilësore, dinamike dhe gjithëpërfshirëse ku shanset individuale për progres dhe mirëqenie mbështeten e zgjerohen në mënyrë të barabartë. *Misioni i Qeverisjes Vendore sipas nenit 3 të Ligjit 139/2015, është:*

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;*
- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;*
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;*
- ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;*
- d) realizimit të shërbimeve në formë të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;*
- dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;*
- e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera.*

Qëllimi i përgjithshëm: Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, social dhe territorial, nëpërmjet shpërndarjes së drejtë të burimeve financiare duke prekur gjithë territorin e bashkisë Kamëz.

Objektiv i përgjithshëm: Të garantohet që gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit nga çdo strukturë, të gjitha veprimet e nevojshme që janë kryer janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË/KAMEZ 2026-2028 DHE BUXHETI VJETOR 2026

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë Kamëz, gjatë periudhës 2026-2028, si dhe projekteve kryesore të investimeve publike, nëse janë planifikuar të tillë. Nder investimet me të rëndësishme është planifikimi Ndertimin e Godines se Bashkise dhe sheshiut si dhe Parkimin Nentoksor. Nënseksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2026-2028, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit. Nënseksioni i dytë, paraqet një përmbledhje të planeve të shpenzimeve të Bashkisë për vitet 2026-2028. Ky nënseksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse. Në vijim paraqiten projektet kryesore të investimeve publike të planifikuara nga Bashkia.

Tabela 1 paraqet të dhëna bazë mbi bashkinë që përshkruajnë demografinë, sipërfaqen, komunitetin dhe bazën e biznesit, kapacitetin menaxhues, etj.

Tabela 1. Informacion Bazë mbi Bashkinë Kamez

RAPORTI PBA9: INFORMACION MBI NJVQV/PROGRAMIN

Tabela e numërit të punonjësve

Nr	Emertimi	Punonjes	Punonjes	Punonjes
		viti 2026	viti 2027	viti 2028
1	Aparati I Bashkise Kamez & Q.Multifunkionale	483	483	485
2	Ndermarrja Pastrim	176	176	178
3	Ndermarrja e Sherbimeve Publike	104	104	106
4	Ndermarrja e Gjelberimit Parqeve dhe Rekreacioneve	159	159	159
5	Ujitja dhe Kullimi	5	5	5
6	Mbrojtja nga Zjarri	49	49	49
7	Personeli mesimor dhe jo mesimor Arsimi parashkollor	441	441	443
8	Personel Qerdhe	135	135	135
9	Personeli ndihmes Arsimi parauniversitar	22	22	22
	total	1574	1574	1582

4.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë/Kamez në vitet 2026-2028

4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Kamez për vitin 2026 dhe PBA e viteve 2026-2028

Ky nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korrent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit

BURIMET E FINANCIMIT TE BASHKISE KAMEZ PER VITET 2026-2028,

Nr	EMERTIMI	PLANI	PLANI	PLANI
		Vjetor 2026	Vjetor 2027	Vjetor 2028
1	Trasferta e pakushtëzuar	836,162,140	880,022,294	924,425,494
	Trasferta e pakushtëzuar(ritja e nivelit te pagave)	120,770,808	120,770,808	120,770,808
	Shuma Trasferta e pakushteuar	956,932,948	1,000,793,102	1,045,196,302
2	Trasferta specifike Arsimi parashkollor	327,205,442	327,205,442	327,205,442
3	Trasferta specifike Arsimi parauniversitar	12,815,744	12,815,744	12,815,744
4	Trasferta specifike Ujitja dhe kullimi	4,264,221	4,264,221	4,264,221
5	Trasferta specifike Mbrojtja kunder zjarrit (PMNZSH)	61,389,393	61,389,393	61,389,393
6	Administrimi i Pyebve	606,918	606,918	606,918
7	Trasferta e pakushteuar (menaxhimi i mbetjeve urbane)	39,576,990	39,576,990	39,576,990
	Shuma Trasferta Sektoriale	445,858,708	445,858,708	445,858,708
	Shuma e Transfertes	1,402,791,656	1,446,651,810	1,491,055,010
1	Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore	664,946,067	679,159,153	693,745,631
2	Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit te Zhvillimit te Territorit	2,486,223,646	2,404,634,821	2,414,408,354
3	3% nga lejet e ndertimit per programet e strehimit	320,000,000	323,200,000	326,432,000
4	Drejtoria e Kadastres Pyjeve dhe Kullotave	8,652,880	8,528,480	8,402,480
5	Te Ardhura nga Legalizimet	350,999,324	260,280,702	227,189,123
6	Te Ardhura nga Drejtoria e Sherbimeve Publike	28,150,000	28,300,000	29,718,000
7	Te Ardhura nga Drejtoria e Transportit dhe Licencave	103,244,000	114,193,500	124,726,000
8	Te ardhura arketim nga kopshtet e cerdhet	38,000,000	38,000,000	38,000,000
9	Te tjera(tarifa shembimi, gjoba polbashkiake e ndertimore) etj	72,866,000	72,866,000	73,551,980
	Shuma e te Ardhurave	4,073,091,917	3,929,162,656	3,936,173,566
	T O T A L I I BURIMEVE TE FINANCIMIT vit	5,475,873,573	5,375,814,466	5,427,228,576

BURIMET E FINANCIMIT TE BASHKISE KAMEZ PER VITET 2026, 2027, 2028

Tabela analitike e te ardhura per vitet 2026-2028

Nr	EMERTIMI	PLANI	PLANI	PLANI
		Vjetor 2026	Vjetor 2027	Vjetor 2028
		0	0	0
I	Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore	664,946,087	679,159,153	693,745,631
	Taksa dhe tarifa lokale (biznes)	377,946,067	389,123,153	400,636,551
1	Takse ndertese	69,634,121	71,723,145	73,874,839
2	Tarife pastrimi te mbetjeve	109,357,273	112,637,991	116,017,131
3	Tarife gjelberim dhe ndricim	57,734,176	59,466,200	61,250,186
4	Takse tabele	464,860	478,805	493,170
5	Taksa reklame	4,687,013	4,827,623	4,972,452
6	Taks e truallit per qellime biznesi	6,328,190	6,518,036	6,713,577
7	Tarife sherbimi	1,048,973	1,080,442	1,112,855
8	Takse hotelerise	187,460	193,084	198,876
9	Debitor viti	109,051,250	112,322,788	115,693,471
10	Takse tregjeve dhe zenie hapsirave publike	680,727	701,149	722,183
11	Takse e perkohshme e rrjetit kabllor, ajror dhe nentoksor	2,076,315	2,138,805	2,202,763
12	Taksa e kalimit te pronese	3,376,526	3,376,526	3,376,526
13	Taksa vendore biznes i vogel (tatim fitimi)	2,000,000	2,000,000	2,000,000
14	Tarife vendore per infrastrukturen arsimore	11,319,184	11,658,759	12,008,522
15	Taksa dhe tarifa lokale (familjaret)	287,000,000	290,036,000	293,106,060
	Ndertesa	81,800,000	82,200,000	82,800,000
	Tarife pastrim	71,400,000	71,925,000	72,450,000
	Tarife gjelberim dhe ndricim	71,400,000	71,925,000	72,450,000
	Taksa e truallit per qellime banimi	1,000,000	1,000,000	1,000,000
	Tarife vendore per infrastrukturen arsimore (familjare)	20,400,000	20,550,000	20,700,000
	Taksa dhe tarifa lokale (familjaret) debitor	41,200,000	42,436,000	43,709,080
	Legalizimet	350,999,324	280,280,702	227,189,123
1	Taksa e ndikimit te legalizimeve debi	321,600,584	230,000,000	196,000,000
2	Taks e ndikimit te legalizimeve v 2024	28,398,740	30,280,702	31,189,123
II	Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit te Zhvillimit te Territorit	2,456,223,646	2,482,834,821	2,412,128,642
1	Leje ndertimi, leje zhvillimi	2,395,352,686	2,403,352,686	2,323,073,974
2	Leje perdorimi	10,181,130	12,241,260	13,250,000
3	Ngritje kanjeri e muri rrethues	1,544,340	9,479,821	10,500,000
4	Piketimi i strukture	5,168,000	6,985,254	7,500,000
5	Perfundimi i themeleve	5,168,000	6,985,254	7,500,000
6	Perfundimi ne fazen e karabinase	4,785,300	6,514,236	7,100,000
7	Perfundimi i fasadave dhe rifinitures	6,563,480	2,085,668	2,085,668
8	Perfundimi i sistemit te jashtem	5,369,710	7,459,842	7,800,000
9	Tarife per zhvillim	9,150,000	11,150,000	13,500,000
10	Tarife per leje	9,150,000	11,150,000	13,500,000
12	Tarife sherbimi	3,791,000	5,231,000	6,520,000
VI	te ardhura 3% strehimi	320,000,000	323,200,000	326,432,000
3	3% strehimi	320,000,000	323,200,000	326,432,000
III	Drejtoria e Kadastres Pyjeve dhe Kultotave	8,652,880	8,528,480	8,402,480

1	Shitje Toke	338,480	338,480	338,480
10	Taksa mbi token	8,314,400	8,190,000	8,064,000
IV	Drejtoria Trans liq e sherbimeve pulike	103,244,000	114,193,500	124,726,000
1	Takse regjistrimi automjetesh	71,623,000	78,640,000	84,946,000
2	Leje transporti transporti taksi	3,940,200	4,400,000	4,900,000
3	Leje transporti transporti udhetaresh	2,870,800	3,500,000	3,990,000
4	Leje transporti transport mallrash	5,500,000	5,953,500	6,600,000
5	Leje Aktiviteti	3,510,000	4,150,000	4,800,000
6	Autorizim per tregti karburanti me pakice	9,000,000	10,000,000	11,000,000
7	Parkim I rezervuar	5,900,000	6,600,000	7,500,000
	Te tjera tarifa administrative	900,000	950,000	990,000
V	Drejtoria Sherbimeve pulike	28,150,000	28,300,000	29,718,000
1	Te ardhura nga parkingjet	20,600,000	20,600,000	21,218,000
2	Tarife nga MKZ	7,550,000	7,700,000	8,500,000
VII	Te Tjera	110,866,000	110,866,000	111,531,980
1	Taks e deleguar te ardhura nga TAP	50,000,000	50,000,000	50,000,000
2	Gjoha Inspektoriat Ndertimor	17,510,000	17,510,000	18,035,300
3	Gjoha Policia Bashkiake	2,575,000	2,575,000	2,652,250
4	Te ndryshme	2,781,000	2,781,000	2,864,430
5	Te ardhura nga kopshtet e cerdhet	38,000,000	38,000,000	38,000,000
	TOTALI	4,043,081,917	4,007,162,656	3,933,894,856
	0.1 % qe do te derdhet ne K. e Qarkut	4,043,082	4,007,163	3,933,895
	Mbeten te ardhura Bashkise	4,039,038,835	4,003,155,493	3,929,960,961

RAPORTI PBA2) PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE

4.1.1.1 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë/Kamez

Ky nënseksion paraqet informacion mbi të ardhurat e veta, përfshirë ato faktike për dy vitet e mëparshme, të pritshmet për vitin aktual dhe parashikimet për periudhën tre-vjeçare të PBA-së. Informacioni mbi supozimet që qëndrojnë në themel të këtyre parashikimeve paraqitet për secilin zë kryesor të të ardhurave të veta.

A. Taksat dhe Tarifat Vendore

A.1 Taksat Vendore

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi token bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to; b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksa e tabelës; d) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; dh) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël; e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore; ë) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

A.2 Tarifat Vendore

Tarifat vendore përfshijnë tarifat për:

- a) tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave; b) tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve; c) tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizimet; ç) tarifa për shërbimin e ujitjes dhe të kullimit; d) tarifa për shërbimet administrative dhe dhënie të licencave, lejeve e autorizimeve; dh) tarifa të përkohshme, në përputhje me rrethanat të përcaktuara në ligj; e) tarifa të tjera, të përcaktuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore; ë) tarifa të tjera, të përcaktuara në ligj.

PBA është hartuar në përputhje me standartet bashkëkohore si dhe mbështetet në trajnimet e specialistëve të financës, tatim - taksave, shërbimeve publike, urbanistikes, burimeve njerëzore, prokurimeve etj, të organizuara nga Ministria e Financës, Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, , si dhe mbështetur në përvojën pozitive të akumuluar.

PBA është fokusuar në programet prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe shqetësimeve të drejtpërdrejta të komunitetit, të evidentuara: (përveçse mbështetur në dokumenta strategjik) edhe:

I. Gjatë punës sonë të përditëshme në drejtim të përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve.

II. Nga takimet e Kryetarit të Bashkisë me qytetarë.

III. Nga kërkesat dhe ankesat e qytetarëve adresuar administratorëve të lagjeve dhe njësive administrative.

IV. Nga degjесat publike organizuar pas fazes së parë të përgatitjes së PBA.

I. Projekt Buxheti Afatmesem i Bashkisë për vitet 2026-2028

Buxheti i Bashkisë për vitin 2026 është parashikuar 5,475,874 mijë lekë, nga të cilat 4,073,082 mijë lekë ose (74.38 %) nga të ardhurat e veta, 956,933 mijë lekë ose (17.48 %) transfertë e pakushtëzuar, 445,859 mijë lekë ose (8.1%) transfertë sektoriale, transfertë e kushtëzuar është gjendja civile, ndihmë ekonomike dhe paaftësi e kushtëzuar për të cilat çelet fondi në fillim të vitit kalenderik.

Buxheti i Bashkisë për vitin 2027 është parashikuar 5,375,814 mijë lekë, nga të cilat 3,929,163 mijë lekë ose (73.09 %) nga të ardhurat e veta, 1,000,793 mijë lekë ose (18.62 %) transfertë e pakushtëzuar, 445,859 mijë lekë ose (8.29%) transfertë sektoriale, transfertë e kushtëzuar është gjendja civile, ndihmë ekonomike dhe paaftësi e kushtëzuar për të cilat çelet fondi në fillim të vitit kalenderik.

Buxheti i Bashkisë për vitin 2028 është parashikuar 5,427,229 mijë lekë, nga të cilat 3,936,174 mijë lekë ose (72.53 %) nga të ardhurat e veta, 1,045,196 mijë lekë ose (19.26 %) transfertë e pakushtëzuar, 445,859 mijë lekë ose (8.22%) transfertë sektoriale, transfertë e kushtëzuar është gjendja civile, ndihmë ekonomike dhe paaftësi e kushtëzuar për të cilat çelet fondi në fillim të vitit kalenderik.

Disa tregues të rëndësishëm për buxhetin

- ☐ Të ardhurat nga taksat vendore zënë rreth 80 % të totalit të të ardhurave nga burimet e veta vendore.
- ☐ Të ardhurat nga tarifat vendore zënë rreth 9.7 % të totalit të të ardhurave nga burimet e veta vendore.
- ☐ Të ardhurat nga burime të tjera zënë rreth 10.3 % të totalit të të ardhurave nga burimet e veta vendore.
- ☐ Totali i shpenzimeve kapitale zë rreth 45 % të totalit të shpenzimeve.
- ☐ Totali i shpenzimeve për tre ndërmarrjet e shërbimit në varesi të Bashkisë Kamez zë rreth 14 % të totalit të shpenzimeve.

Të ardhurat e veta vendore

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës së kushtëzuar. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Specifika e këtyre të ardhurave, sipas nenit 40/1 të ligjit është që nëse nuk shpenzohen brenda vitit fiskal, trashëgohen në vitin tjetër fiskal. Pra, pjesë përbërëse e këtyre të ardhurave janë dhe ato që trashëgohen nga viti i mëparshëm.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë për vitin 2026-2028, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Gjithashtu planifikimi i të ardhurave të veta u realizua si proces në bashkëpunim me administratën e bashkisë, me Njësinë Administrative, , etj. Ky proces bashkëpunues do të mundësojë sigurimin e të ardhurave të mundshme për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm në të gjithë territorin e bashkisë.

Të ardhurat nga burimet e veta vendore

Të ardhurat nga burimet e veta vendore llogariten në **4,073,082** mijë lekë. Ato përfshijnë të ardhurat nga taksat, të ardhurat nga tarifat dhe të ardhurat nga burime të tjera. Pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë të ardhurat nga taksat (74.38 %).

Zërat e taksave dhe tarifave që ndikojnë pjesën më të madhe të planit të të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2026, janë kryesisht taksa e ndikimit në infrastrukturë që zë rreth 61 %, tarifat për pastrim, gjelberim e ndriçim që zë rreth 7.82 %, taksa e pasurisë së paluajtshme që zë rreth 3.82 %, Tarifë infrastrukturë arsimit e përkohshme që zë rreth 1. %, taksa e mjeteve të përdorura që zë rreth 1.84%.

Këto zëra kryesorë mbulojnë mbi 80 % të planit të të ardhurave të Bashkisë.

Tabela e mëposhtme pasqyron planin e të ardhurave të veta për vitin 2026, të kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik ligjor:

Tabela analitike bashkëlidhur.

Të ardhurat e veta vendore

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës së kushtëzuar. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Specifika e këtyre të ardhurave, sipas nenit 40/1 të ligjit është që nëse nuk shpenzohen brenda vitit trashëgohen për vitin e ardhshëm.

Kapacitetet fiskale të taksapaguesve

Paguesit e nivelit të taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative. Për përcaktimin e numrit të tyre janë konsideruar të dhënat për taksapaguesit e një viti më parë, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të vitit 2026 të miratuar nga këshilli i bashkisë. Në total numri taksapaguesve është parashikuar rreth 43,571 (familje, biznese dhe institucione).

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse e kapacitetit të taksapaguesve sipas kategorive dhe për njësinë administrative.

KAPACITETI I TAKSAPAGUESVE SIPAS GRUPIMEVE (Numri)

Nr.	Bashkia Kamëz	Familjet	Biznes i vogël	Biznes i madh
1	Kamëz	24.060	2.308	701
2	Paskuqan	15.647	918	163
	Totali	39.707	3,226	864

Taksapaguesit familjarë,

Në total numri i familjeve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë është 39.707 familje. Numri i familjeve në njësinë administrative Kamez zë peshën kryesore me 24.060 familje ose 60.59 % të numrin të përgjithshëm të familjeve në Bashkinë Kamëz.

Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke ju përafëruar kapaciteteve reale të familjeve rezidente dhe duke mesatarizuar numrin e arkëtimeve në vitet e kaluara sipas zonave me numrin e familjeve sipas gjendjes civile.

Në planin e të ardhurave janë parashikuar lehtësi fiskale për familjet me probleme sociale, si për familjet që janë invalidët, familjet vetëm me pensionist dhe familjet që preken nga projektete infrastrukturore ..etj.

KAPACITETI I FAMILJEVE TAKSAPAGUESE

Nr.	Bashkia Kamëz	Familje me taksa e tarifa të plota	Familje me lehtësi fiskale
1	Kamez	24.060	4.066
2	Paskuqan	15.647	1.501
	Totali	39.707	5.567

Taksapaguesit biznese dhe institucione

Bazuar në regjistrat aktual, në total, numri i bizneseve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë është 4.090 biznese, ku Biznesi i vogël është 3,226 biznese ose zë 78 % të numrit total të bizneseve.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse për bizneset sipas xhiros, sipas institucioneve dhe Njësi Administrative:

KAPACITETI I BIZNESEVE DHE INSTITUCIONEVE TAKSAPAGUESE

Nr.	Bashkia Kamëz	Totali i bizneseve	Biznes i Vogël	Biznes i Madh
-----	---------------	--------------------	----------------	---------------

1	Kamëz	3,009	2,308	701
2	Paskuqan	1,081	918	163
	Totali	4,090	3,226	864

KAPACITETI I BIZNESEVE TË VEGJËL SIPAS NATYRËS SE TTYRE

Nr.	Bashkia Kamëz	Biznesi i vogël	Njësi tregtare dhe shërbimi	Njësi prodhimi	Profesione të lira	Ambulant
1	Kamëz	2,308	2,039	148	121	0
2	Paskuqan	918	820	58	39	1
	Totali	3,226	2,859	206	160	1

Analiza e të ardhurave të veta vendore dhe ndikimet e tyre në të ardhurat e bashkisë,

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, nga tarifat për shërbimet publike dhe të ardhurat e tjera vendore.

Sipas ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/2, bashkitë e ushtrojnë të drejtën evendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimit të tyre brenda kufijve e sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.

Llogaritja e të ardhurave të kësaj kategorie mbështetet në:

1. Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar;
2. Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
3. Vendimin e Këshillit të Bashkisë Kamëz Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz“;

Të ardhurat nga taksat vendore

Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", me ndryshimet përkatëse, përbën ligjin bazë i cili përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të taksave vendore, mbledhjes dhe administrimit të tyre.

Paketa fiskale e bashkisë për këtë kategori e hartuar dhe me përfshirjen e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit e më konkretisht biznesit të madh (juridik dhe fizik) dhe të vogël (fizik), banorëve të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interes, këshilltarë etj, pasqyron disa politika të rëndësishme për uljen e disa niveleve ligjore/kufi, etj. sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:

Në vitin 2026 të ardhurat nga taksat përbëjnë rreth 80. % të të ardhurave nga burimet e veta të bashkisë.

Pjesë e rëndësishme në këtë kategori të taksave vendore janë të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, e cila zë mbi 61. % të totalit të ardhurave të veta dhe më pas vijnë të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme 3.82 %, taksa e ndikimit në infrastrukturën arsimore të përkohshme 1%, dhe më pas të ardhurat nga taksa e mjeteve të përdorura 1.84 % etj.

Të ardhurat vendore nga taksat vendore***Të ardhura nga Taksa mbi pasurinë e paluajtshme***

Këto të ardhura përfshijnë të ardhurat nga :

- Taksa mbi ndërtesat (mbi ndërtesat e banimit dhe mbi ndërtesat e tjera)
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

a) Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat***Taksa mbi ndërtesat e banimit***

Baza e taksës është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat.

Gjatë vitit parashikohet zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

Bashkia parashikon që të gjejë mbështetje edhe tek institucionet e tjera si Zyra vendore e regjistrimit të pasurisë për saktësimin dhe përpilimin e një regjistri sa më të saktë të banesave në territorin e saj.

Planifikimi i të ardhurave për këto ze për vitin 2026-2028 është bërë përlogaritje për çdo biznes dhe familje, tek të ardhurat e realizuara vitin e mëparshen, si dhe duke iu referuar tendencës në rritje të kapacitetit të realizimit të të ardhurave ndër vite. Sipërfaqja e ndërtesave të banimit që taksohet është në process verifikimi ketu futen dhe debite e vitit të kaluar.

Persa i përket peshës së të ardhurave nga kjo taksë, nëse i referohemi kategorisë së banesave, pjesa më e madhe e të ardhurave nga taksa mbi ndërtesat e banimit vjen nga banesat e ndërtuara pas vitit 1993.

Të ardhura nga taksa e ndërtesës për biznese

Kjo taksë administrohet nga Bashkia. Baza e taksës është sipas rastit sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat.

Planifikimi i të ardhurave për vitet 2026-2028 është bërë mbi bazën e sipërfaqes aktuale të bizneseve në juridiksionin e bashkisë.

Kapaciteti totali i sipërfaqes së taksueshme për qëllime biznesi është në process saktësimi.

Ndërsa, nëse i referohemi kategorive të banesave, pjesa më e madhe e të ardhurave nga taksa mbi ndërtesat e tjera të biznesit vjen nga ndërtesat e biznesit për tregti e shërbime.

Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore,

Kjo taksë administrohet nga Bashkia. Baza e taksës është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi ose në përdorim të taksapaguesit.

Më lartë paraqitet tabela e të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore, sipas kategorive të tokës dhe njësive administrative:

Gjatë vitit parashikohet saktësimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

Planifikimi i të ardhurave për këtë ze për vitin 2026-2028 është bërë duke u bazuar në kapacitetin aktual të njësive administrative dhe bazuar në parashikimin për saktësimin

